

20051091495

L I G J
PËR GARANTIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË OBLIGIMEVE NË
MARRËVESHJEN PËR HUA, DEDIKUAR PËR PROJEKTIN PËR REFORMA NË
HEKURUDHË, I CILI DO TË LIDHET MIDIS NP HEKURUDHAT E MAQEDONISË
DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR PËRTËRITJE DHE ZHVILLIM

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes për hua të dedikuar për Projektin për reforma në hekurudhë, i cili do të lidhet midis NP Hekurudhat e Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Përtëritje dhe Zhvillim, në shumë prej 15.000.000 euro, sipas afateve dhe kushteve të parapara në Marrëveshjen për hua, vetëm në rastet kur NP Hekurudhat e Maqedonisë nuk do t'i plotësojë dhe servisojë obligimet e Marrëveshjes për hua.

Neni 2

Kushtet dhe shfrytëzimi i huas nga neni 1 nga ky ligj, do të përcaktohen me Marrëveshjen për hua midis NP Hekurudhat e Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Përtëritje dhe Zhvillim.

Neni 3

Të gjitha obligimet financiare të cilat dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas, do t'i kryejë NP Hekurudhat e Maqedonisë nga të hyrat të cilat i realizon, në afatet dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 4

Afati për kthimin e huas nga neni 1 nga ky ligj është 17 vjet, me grejs periudhë prej 5 vjetësh dhe shkallë të kamatës LIBOR +0.75% në vit.

Huaja do të paguhet në 24 anuitete gjysmëvjetori, duke filluar prej 15 prill 2011 deri 15 tetor 2022 në shumë prej 625.000 euro.

Gjatë grejs periudhës prej 5 vitesh, që paraqet edhe periudhë të realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Neni 5

Me datën ose menjëherë pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për hua nga neni 2 nga ky ligj, paguhet provizion i shkurtër-shpenzim në shumë prej 1% nga shuma e huas.

Shuma e provizionit të shkurtër mund të jetë edhe më e vogël se 1% në bazë të vendimit të marrë paraprakisht të Bankës Ndërkombëtare për Përtëritje dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Për shumën e mjeteve të patërhequra të huas paguhet provizion në lartësi prej 0,75% në vit të përcaktuar nga ana e Bankës Ndërkombëtare për Përtëritje dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Provizioni nga paragrafi 2 nga ky nen paguhet në gjysmëvjetor edhe atë me 15 prill dhe me 15 tetor secilin vit.

Neni 6

Nëse obligimet e arritura në bazë të kamatës dhe kryegjësë, në afatet e përcaktuara me Marrëveshjen për hua, në emër të NP Hekurudhat e Maqedonisë është e detyruar t'i paguajë Republika e Maqedonisë, NP Hekurudhat e Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e kryerjes së obligimit, të bartë në dobi të llogarisë së të hyrave të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, mjete në denarë në lartësinë e pagesës së kryer, të zmadhuar për kamatën e llogaritur dhe për shpenzimet e paraqitura të lidhura me transaksionin adekuat.

Ministri i Financave mund t'i japë urdhëresë Drejtorisë së të hyrave publike për bllokimin e mjeteve të NP Hekurudhat e Maqedonisë në bazë të kthimit të TVSH me qëllim që të përmbushen obligimet e arritura ndaj kreditorit, respektivisht t'i kompensohen shtetit mjete në denarë në lartësinë e pagesës së kryer, të zmadhuar me kamatën e llogaritur dhe për shpenzimet e paraqitura lidhur me transaksionin adekuat.

Neni 7

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve midis tyre, të cilat dalin nga Marrëveshja për hua dhe Marrëveshja për garantim, Ministria e Financave dhe NP Hekurudhat e Maqedonisë do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.